



BASHKIA  
TIRANË

**Drejtuar:** Bashkimit të Operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” shpk  
&”Glavenica”

shpk

**Adresa:** Tiranë, Dajt, Lagjja Qesarake, godinë banimi dhe shërbimesh 3,4- kate, +  
nënçati + 2 kate bodrum, kati i I & Fier, Ballsh, Lagjja 5- Shkurti,  
Bulevardi 4

Heronjtë, godina nr.2, apartament nr.3, kati 4.

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e Hapur”, “Rikontruksion i rrugës Kadri Kërçiku”.

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është: “Rikontruksion i rrugës Kadri Kërçiku”.

**Numri i referencës së procedurës/lotit:** REF-10520-02-25-2019

**Fondi limit:** 34,336,598 (tridhjetë e katër milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2019, miratuar me VKB Nr. 159, datë 21.12.2018 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 6 (gjashtë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes sëkontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** 28.03.2019, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 9 datë 04.03.2019

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1.Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk**

NUIS K020030010

Vlera e ofertës 24,636,891.88 (njëzetë e katër milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e një pikë tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

## 2.Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” shpk

NUIS K71820009I

Vlera e ofertës = 27,454,862.18 (njëzetë e shtatë milion e katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

## 3.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Senka” shpk

NUIS J94808405Q

Vlera e ofertës = 28,499,997 (njëzetë e tetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

## 4.Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” shpk &”Glavenica” shpk.

NUIS K11507003S & NUIS

K17710805A

Vlera e ofertës = 29,210,254 (njëzetë e nëntë milion e dyqind e dhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

## 5.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk

NUIS

K47103804L

Vlera e ofertës = 29,966,015 (njëzetë e nëntë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

### Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

#### 1.Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk

NUIS K02003001O

- Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk është i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B, çka bie në kundërshtim me me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik.
- Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk plotëson kriterin teknik të DST: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)/ Kamion me kapacitet mbajtës 7 - 10 ton/ 2 (dy) copë” **pasi nga të gjithë kamionët e paraqitur vetëm 1 plotëson kapacitetin mbajtës 7-10 ton nga 2 (dy) copë të kërkuar.**
- Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk plotëson kriterin teknik të DST: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)/ Autopompe betoni” **pasi nuk ka deklaruar në Shtojcën 10 mjetin Autopompë Betoni.**
- Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk plotëson kriterin teknik të DST: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në

*dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)/ Grejder” **pasi nuk ka deklaruar në Shtojcën 10 mjetin Grejder.***

- Operatori ekonomik “Eurondërtimi” shpk nuk plotëson kriterin teknik të DST: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)/ Eskavator me goma” **pasi mjeti eskavator me goma është deklaruar dhe paraqitur vetëm me fatura zhdoganimi dhe jo me dokumentacionin e kërkuar.**
- Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk plotëson kriterin teknik të DST: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)/ Autobitumatrice” **pasi nuk është deklaruar dhe paraqitur dokumentacion për mjetin Autobitumatrice por është deklaruar vetëm Bitumatrice.**
- Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk plotëson kriterin teknik të DST: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)/ Autobot” **pasi për mjeti Autobot Uji me targë AA 418 UC rezulton Autobot uji i montuar.**
- Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk plotëson kriterin teknik të DST: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)/ Autovinc” **pasi për mjetin Autovinc me targë AA 069 FJ nuk është paraqitur certifikata për transport mallrash brenda vendit.**
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

## **2.Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” shpk**

**NUIS**

K71820009I

- Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur kopjen e deklaramit të Xhiros vjetore për vitin 2015, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.
- Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur Vërtetimin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2018, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 3.
- Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur Vërtetim lëshuar nga Administrata tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin Shkurt 2019, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika pika 4, gërma “a”.
- Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur për stafin teknik, rezulton se nuk është paraqitur Libreza e Punës për Inxhinierin e Mjedisit, çka bie në kundërshtim me DST,

Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.

- Opearatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar pranë shoqërisë 1 (një) Ekspert Zjarrfikës, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- Shoqëria “Leon Konstruksion” shpk ka paraqitur dokumentacion vetëm për 1 (një) punonjës teknik ndërtimi, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8, ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:*
  - *2 (dy) punonjës teknik ndërtimi*
  - *2 (dy) punonjës hidraulik*
  - *4 (katër) punonjës elektrikistë*
  - *2 (dy) punonjës murator*
  - *2 (dy) punonjës pllakashtrues*

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmite e kualifikimit te sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit.”*

- Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” nuk ka paraqitur Liçencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis (Kodi III.2.B), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17.
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Kamiona me kapacitet mbajtës 7-10 Ton, përkatësisht me targa AA 152 VK si dhe AA 840 UF. Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues rezulton se mjeti me targa AA 152 VK ka kapacitet mbajtës 3.4 Ton; ndërsa mjeti me targa AA 840 UF ka kapacitet mbajtës 2.4 Ton. Për sa më lart asnjë nga kamionët e deklaruar nuk plotëson kapacitetin mbajtës të përcaktuar në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18 ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 2 (dy) kamiona me kapacitet mbajtës 7-10 Ton”*.
- Operatori ekonomik nuk ka deklaruar se disponon Fadromë me goma, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18.
- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar se disponon 1 (një) Autobitumatriçe, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18.
- Operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobot uji me targa AA 120 NA. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur mbi disponimin, rezulton se mjeti me targa AA 120 NA rezulton të jetë i montuar = Kamion AA 120 NA + depozitë uji, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18 ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobot uji”*.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë

29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Leon Konstruktion” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

### **3.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Senka” shpk**

**NUIS**

J94808405Q

Vlera e ofertes se paraqitur nga shoqëria “Senka” shpk është 28,499,997 (njëzetë e tetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH. Pas konstatimit të gabimit aritmetik, vlera e absolute e korrigjimit aritmetik rezulton më e madhe se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. Në mbështetje të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” (i ndryshuar) , Kreu VII, Neni 66, pika 4 oferta e ketij Operatori Ekonomik refuzohet.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve ekonomik “Dajti Park 2007” shpk & “Glavenica” shpk.**, me adresë: Tiranë, Dajt, Lagjja Qesarake, godinë banimi dhe shërbimesh 3,4- kate, + nënçati + 2 kate bodrum, kati i I & Fier, Ballsh, Lagjja 5- Shkurti, Bulevardi 4 Heronjtë, godina nr.2, apartament nr.3, kati 4, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **29,210,254** (njëzetë e nëntë milion e dyqind e dhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **29,966,015** (njëzetë e nëntë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

### **Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 17.04.2019**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.